

Hyrje

Në përputhje me përkufizimet e pranuar ndërkombëtare, edukimi financiar është një proces i cili duhet të mundësojë të kuptuarit më të mirë të produkteve, koncepteve dhe rreziqeve financiare, si dhe zhvillim i aftësive për përzgjedhje përkatëse dhe sjellje të vendimeve të qëndrueshme në lidhje me produktet dhe shërbimet financiare dhe menaxhimin e financave personale, që në fund të fundit kontribuon për mirëqenie të zmadhuar të popullsisë. Edukimi financiar është ngushtë i lidhur me inkluzionin financiar, gjatë së cilës arsimimi më i lartë financiar, informimi më i mirë dhe gatishmëria për sjelljen e vendimeve financiare të mençura dhe të qëndrueshme, në përgjithësi duhet të kontribuojë për inkluzion më të lartë financiar. Inkluzioni financiar duhet të sigurojë qasje përkatëse të personave juridik dhe fizik deri te llojet e ndryshme të produkteve dhe shërbimeve financiare, të qasme në mënyrë përkatëse dhe nën kushte përkatëse për të gjithë personat (subjektët) e interesuar. Inkluzioni më i lartë financiar mundëson përdorimin e përparësive nga produktet dhe shërbimet financiare, që në fund të fundit duhet të mbështet zhvillimin ekonomik. Inkluzioni financiar është në mënyrë të pashmangshme i kushtëzuar edhe nga mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve në produkte dhe shërbime të ndryshme financiare. Sistemi për mbrojtjen e konsumatorëve në sferën e financave përfshin rregullativë përkatëse ligjore dhe vendosje institucionale të cilat sigurojnë mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve, konkurrencë të drejtë në treg dhe shkëmbim të lirë të informatave, si parakushte të rëndësishme për mbrojtjen e konsumatorëve, në veçanti personat fizik të cilët nuk kanë njohuri dhe ekspertizë të mjaftueshme që në mënyrë autonome të mbrojnë të drejtat e veta.

Edukimi financiar dhe mbrojtja e konsumatorëve janë segmente që plotësohen dhe ato duhet të mbështesin inkluzionin financiar. Gjatë kësaj, parakushti kryesor për inkluzion më të madh financiar është një sistem financiar kryesisht i shëndoshë, i qëndrueshëm dhe efikas. Njëkohësisht, klientët e edukuar dhe të informuar më mirë, të cilët më mirë menaxhojnë me asetet e veta poashtu kontribuojnë për stabilitetin financiar. Rreziku nga sjellja e vendimeve të paqëndrueshme financiare, si pasojë e arsimimit të pamjaftueshëm financiar në nivel individual dhe në nivel të amvisërisë, ka ndikim negativ mbi sektorin financiar, andaj zbatimi i kësaj strategjie në nivel nacional bëhet domosdoshmëri.

Kjo strategji ka për qëllim të sigurojë mbështetje dhe zhvillim të mëtejshëm të edukimit financiar dhe inkluzionit financiar, si dhe përmirësim dhe/ose vendosje të kornizës përkatëse ligjore dhe institucionale për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Strategjia duhet të kontribuojë për koordinim dhe bashkëpunim të përforcuar midis rregullatorëve financiar, sektorin privat financiar dhe sektorin joqeveritar, si dhe qasje sistematike të të gjithë subjektëve të kyçur me qëllim të përforcimit të arsimimit financiar të popullsisë, përmirësim të nivelit të inkluzionit financiar, me sigurim të njëkohshëm të mbrojtjes përkatëse të

konsumatorëve. Bashkëpunimi midis subjekteve të përfshirë do kontribuonte për optimizimin e resurseve, vazhdimësi në përpjekjet dhe përgjegjësi të rritur kolektive në lidhje me qëllimet e vendosura. Strategjia njëkohësisht është e përqëndruar si në sektorin financiar, poashtu edhe në përdoruesit e shërbimeve dhe produkteve financiare.

Strategjia i merr parasysh praktikat pozitive botërore në këtë sferë, si dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare (OECD, Banka Botërore, institucionet e BE-së).

1. Qëllime të strategjisë

Qëllimet bazë të strategjisë janë:



- Të kontribuojë në të kuptuarit më të mirë të koncepteve dhe nocioneve bazë financiare tek grupe të caktuara të synuara dhe popullsia si tërësi;
- Të përforcojë shkathtësitë e popullsisë për menaxhim me financat personale;
- Të përmirësojë aftësinë e popullsisë për sjellje të vendimeve të drejta në lidhje me produktet dhe shërbimet e ndryshme financiare;
- Të përmirësojë vetëdijësimin tek popullata për përparësitë dhe rreziqet e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve të ndryshme financiare, në ndërkohë duke përforcuar besueshmërinë e tyre në sistemin financiar;
- Të përmirësojë disiplinën financiare të popullsisë, respektivisht të përvetësojë zakone të sjelljes kursyese, shpenzimit dhe humarrjes së përgjegjëshme, si dhe kujdes të përgjithshëm gjatë përdorimit të të gjitha produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara në treg;
- T'i jepet mbështetje inkluzionit financiar, përmes zhvillimit të mëtejshëm të segmenteve të veçanta financiare, sigurimin e një numri më të madh të informatave relevante rreth produkteve dhe shërbimeve financiare, gjatë mbrojtjes përkatëse të të drejtave të konsumatorëve në sektorin financiar;
- Të përforcojë vetëdijësimin për kërkimin e informatave shtesë, si dhe nevojën për edukim të vazhdueshëm në sferën e financave, si një sferë ekskluzivisht dinamike e ekonomisë;
- Të përmirësojë kornizën ekzistuese ligjore dhe vendosjen institucionale me qëllim të vendosjes së një sistemi të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në sferën e financave.

2. Gjendja rrjedhore

Arsimimi financiar

Matja e parë nacionale e nivelit të arsimimit financiar tek popullsia e moshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e kryer në shkurt të vitit 2018¹, tregoi nivel agregat të arsimimit financiar prej 11,8, në përputhje me metodologjinë standarde të INFE. Ky është nivel relativisht më i ulët në krahasim me mesataren e vendeve më të zhvilluara në botë nga Grupacioni 20 deri më 12,7 pikë, mirëpo nga ana tjetër është e krahasueshme me vendet e rajonit.

Grafiku 1




¹ Matja e parë ishte në organizim të Bankës Popullore, e me mbështetje të EFSE, sipas metodologjisë ndërkombëtare të INFE OECD.

Studimi i nivelit të arsimimit financiar në vitin 2018 është kryer përmes ekzaminimit të tre komponenteve më të rëndësishme të cilat janë pjesë përbërëse e arsimimit financiar: dituri financiare, sjellje financiare dhe qëndrime financiare. nga aspekti i komponenteve të indeksit agregat, në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fushëveprimin e diturisë financiare dhe sjelljes financiare, janë vërtetuar rezultate solide, në përputhje me pjesëmarrjen e të anketuarve me minimum pika të synuara (pragu minimal i kënaqshëm). Ashtu, 45% e të anketuarve kanë treguar njohuri solide të koncepteve bazë financiare, që kontribuon për vendime të qëndrueshme financiare. poashtu, 42% e të anketuarve kanë sjellje pozitive financiare, ndër të tjera të shprehur përmes rregullsisë në pagesën e llogarive në amvisëritë dhe shqyrtimin e një numri të opsioneve gjatë zgjedhjes së një shërbimi të caktuar financiar. Nga ana tjetër, tek qëndrimet financiare vërehet realizim më i ulët, respektivisht vetëm 20% e të anketuarve shënojnë qëndrime të cilat janë pozitive në kontekst të arsimimit financiar, që kryesisht e tregon përqëndrimin tek pjesa më e madhe e popullsisë në nevojat afatshkurte financiare, e jo në kursim afatgjat. Edhe pse këto qëndrime mund të jetë pasqyrë e gjendjes ekonomike dhe shoqërore të popullsisë dhe standardit jetësor, megjithatë ky aspekt hap hapësirë për mbindërtim të nivelit të edukimit financiar në këtë fushëveprim.

Matja e dytë e nivelit të arsimimit financiar tek popullsia e moshuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut është kryer në gjysmën e dytë të vitit 2019². Rezultatet e fituara nga të dy matjet janë të krahasueshme, duke pasur parasysh që në të dy anketat është përdorur metodologjia e njëjtë. Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për periudhë relativisht të shkurtë kohore në të cilën janë zbatuar të dy matjet, rezultat agregat është i njëjtë. Gjegjësisht, popullsia në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe në vitin 2018 edhe në vitin 2019 ka realizuar 56% të maksimumit, ose indikator agregat 11,8 (nga të cilët 3,9 për dituri financiare, 5,1 për sjellje financiare dhe 2,8 për qëndrime financiare). Në krahasim me strukturën e indikatorit në vitin 2018, ka vetëm lëvizje të vogla (në vitin 2018 tek dituritë financiare 4, për sjelljen financiare 5 dhe nivel të njëjtë prej 2,8 për qëndrimet financiare). Rezultatet nga anketa e parë, si dhe e dyta bëjnë me dije se nevojitet informim dhe edukim më i madh i popullsisë për përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme bashkëkohore bankare dhe të tjera financiare.

² Matja e dytë e arsimimit financiar u zbatua në kuadër të projektit rajonal për edukim financiar të mbështetur nga Ministria e financave e Holandës dhe INFE OECD.

Grafiku 2




Rezultatet nga studimi në vendin tonë zbulojnë një zbrazëtim midis niveleve të arsimimit tek grupet e ndryshme të popullsisë, duke theksuar nevojën për qasje të diversifikuara gjatë edukimit financiar të grupeve të ndryshme të synuara. Poashtu, niveli i diturive financiare, sipas pikave minimale të synuara, është më i ulët tek gratë sesa tek burrat, e njëherit është më i ulët tek popullsia me arsim më të ulët dhe tek popullsia me të ardhura më të ulëta (gjetje të ngjajshme takohen edhe për vendet/rajonet tjera).

Inkluzioni financiar dhe mbrojtja e konsumatorëve

Inkluzioni financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përputhje me matjen e Bankës botërore – baza Findeks për vitin 2017³, shprehur përmes numrit të personave me llogari në bankë, është relativisht e lartë, dhe në vitin 2017 ka qenë 76,6%, që është në tërësi komparative me mesataren në Evropë dhe Azinë Qendrore (ECA) prej 81,5%. Nga ana tjetër, inkluzioni financiar në anën e huamarrjes është më i ulët, gjatë nivelit njëkohësisht më të ulët edhe në ECA. Gjatë kësaj, huamarrja nga institucionet financiare është relativisht modest. Megjithatë, gjatë analizës së inkluzionit financiar tek huamarrjet, duhet pasur parasysh niveli i zhvillueshmërisë së sistemit financiar.


³ Të dhënat e fundit në dispozicion.

Grafiku 3




Inkluzioni financiar në raport me kartelat pagesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut është më i madh tek kartelat debitore, kundrejt kartelave kreditore, që pjesërisht pasqyron vetitë e ndryshme dhe kriteret e ndryshme për fitimin e këtyre kartelave, e njëherit proporcion i tillë në dobi të kartelave debitore ekziston edhe në ECA. Megjithatë, niveli i përfshirjes në raport me përdorimin e kartelave për blerje është ndjeshëm më i ulët në vendin tonë kundrejt ECA, që konfirmohet edhe me faktin se tek ne është e konsiderueshme pjesëmarrja e transaksioneve me kartela për ngritje të parave të thata nga bankomatet (me tendencë të uljes në vitet e fundit), që bën me dije për përdorimin jo të plotë të përfitimeve nga ky instrument pagesor pa para të thata dhe njëherit, zbulon nevojë për edukim më të madh financiar në këtë fushëveprim. Gjetjet nga anketat e Bankës Botërore zbulojnë edhe përfshirje relativisht më të ulët të popullsisë në RMV kur bëhet fjalë për përdorimin e shërbimeve financiare dhe pagesave përmes internetit.

Grafiku 4



Analiza e përgjigjeve të të anketuarve në kuadër të Anketës për arsimim financiar e vitit 2018 bën me dije se në raport me produktet dhe shërbimet më të reja dhe më të sofistikuara ekziston vetëdijësim më i ulët tek popullsia, në krahasim me njohuritë për produktet klasike, ndërsa tek shumica e produkteve dhe shërbimeve financiare, edhe pse vetëdijësimi është solid, megjithatë përdorimi është ndjeshëm më i vogël. Njohuritë e këtilla bëjnë me dije për nevojën për informim më të mirë të popullsisë në raport me përparësitë, por edhe për rreziqet nga produktet më të reja financiare në treg, me çfarë do sigurohej inkluzion më i madh financiar në segmente të ndryshme financiare.

Grafiku 5



Të dhënat për nivelin relativisht të lartë të inkluzionit financiar nga aspekti i posedimit të llogarisë, tregojnë bazë të mirë për realizimin e një progresi të mëtejshëm në këtë sferë. Niveli i lartë i inkluzionit financiar është me rëndësi jetike për vendin, ku është i nevojshëm përkushtim dhe koordinim i fuqishëm midis institucioneve relevante dhe subjekteve privatë me qëllim që të krijohet qasje e lehtësuar deri te financat dhe politika të gjera të cilat promovojnë sjellje përgjegjëse financiare.

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve, së bashku me edukimin financiar dhe qasjen deri te shërbimet financiare, paraqet bazë për inkluzion më të madh financiar. Mbrojtja e konsumatorëve përfshin: sigurimin e informatave të sakta dhe në kohë deri te konsumatorët për sjelljen e vendimeve në bazë të informatave, mosekzistimin e praktikave të padrejta dhe mashtruese në marrëveshjet, si dhe qasje në mekanizmat për zgjidhjen e shkeljeve të ngjara të të drejtave të konsumatorëve.

Rregullat nga të cilat rrjedhin kompetencat për veprim në fushëveprimin e mbrojtjes së konsumatorëve në vendin tonë, në veçanti në kontekst të përdoruesve të shërbimeve

financiare, janë Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve dhe rregullat nënligjore të cilat rrjedhin nga ai, si dhe Ligji për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore (që është në tërësi i harmonizuar me direktivën evropiane 2008/48/EZ të Parlamentit evropian dhe Këshillit të 22 majit të vitit 2008) dhe rregullat përkatëse nënligjore. Banka Popullore si një organ rregullator dhe supervisor është njëra nga institucionet (së bashku me Ministrinë e ekonomisë dhe Ministrinë e financave) me kompetenca për kontroll të zbatimit të Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore. Banka Popullore është institucion kompetent për kontroll të zbatimit të këtij ligji nga ana e bankave dhe shtëpive të kursimit gjatë miratimit të kredive konsumatore. Gjatë kësaj, supervizioni nga Banka Popullore zbatohet në kuadër të mbikëqyrjes prudente. Raporti për progresin e Komisionit evropian për vendin tonë i vitit 2019 bën me dije për nevojën "për vazhdim të angazhimeve për harmonizim të rregullativave kombëtare me ato evropiane në lidhje me supervizionin prudent për mbrojtje të konsumatorëve dhe parandalim të praktikave të padrejta bankare". Në sektorin e sigurimeve, bazën juridike për aktivitetet e mbrojtjes të konsumatorëve e mundëson Ligji për mbikëqyrjen e sigurimeve. Në sferën e letrave me vlerë, mbrojtja juridike e përdoruesve të shërbimeve në tregun e letrave me vlerë mundësohet me Ligjin e letrave me vlerë, Ligjin për marrje të shoqërive aksionare dhe Ligjin e fondeve të investimeve. Komisioni i letrave me vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut si një organ rregullator ka kompetenca për të kontrolluar zbatimin e këtyre ligjeve dhe të kujdeset për funksionimin ligjor dhe efikas të tregut të letrave me vlerë dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të tij, me qëllim të përforcimit të vazhdueshëm të besueshmërisë së publikut në institucionet e tregut të letrave me vlerë.

3. Rishikim i aktiviteteve të deritanishme

Në vitin 2013 u formua Trupi koordinues i institucioneve rregullatore për edukim financiar me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit midis institucioneve rregullatore në sferën e edukimit financiar. Në trupin koordinues marrin pjesë: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMV-ja), Ministria e financave, Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve (ASO), Komisioni i letrave me vlerë (KLV) dhe Agjencia për mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS). Në vitin 2019, trupi koordinues i rriti kompetencat e veta edhe në sferën e inkluzionit financiar dhe u riemërua në Trup koordinues për edukim financiar dhe inkluzion financiar. Në këtë periudhë u ndërmorrën numër i madh nismash për ngritjen e nivelit të arsimit financiar të popullsisë dhe inkluzion më i madh financiar në vend. Aktivitetet u drejtuan në sferat vijuese:

- Nxitjen e bashkëpunimit midis institucioneve të cilat janë pjesë e Trupit koordinues dhe bashkëpunimi me institucione të tjera relevante përmes zbatimit të programeve dhe aktiviteteve edukative për mbështetje dhe përmirësim të arsimimit financiar të popullsisë;
- Bashkëpunim në projekte të përbashkëta për edukim dhe inkluzion financiar;
- Hartim i dokumenteve strategjike;
- Matje e nivelit të arsimimit financiar dhe inkluzionit financiar të popullsisë;
- Zbatim i sesioneve të punës, seminareve, ligjërimeve dhe evente të tjera publike;
- Promovim i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Ekzistojnë disa aktivitete të përbashkëta për edukim dhe inkluzion financiar që koordinohen nga ana e institucioneve të Trupit koordinues, për çdo vit në një periudhë të dhënë kohore, siç janë: „Java globale e parave“ në mars, „Ditët e arsimimit financiar“ në maj, shënimi i Ditës ndërkombëtare të kursimit më 31 tetor dhe i Ditës së sigurimeve më 1 nëntor. Në vitet e fundit, aktivitetet zgjerohen përmes përfshirjes edhe të popullsisë së moshuar. Në vitin 2019, Ditët e arsimimit financiar u organizuan për të gjithë qytetarët e interesuar. Poashtu, rregullatorët financiar bashkëpunojnë edhe gjatë hartimit të publikimeve edukative, e njëherit përmes Trupit koordinues janë të përfshirë në projektin rajonal për edukim financiar të Ministrisë së financave të Holandës (në kuadër të Konstituencës pranë FMN-së), në bashkëpunim me INFE-OECD. Rregullatorët financiarë mbajnë ligjërata/prezantime të rregullta për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe ligjërata të specializuara për studentë nga sfera e financave, me çfarë kontribuojnë për plotësimin e diturive të të rinjve për këtë sferë⁴.

Poashtu, ekzistojnë edhe një numër i organizatave jofitimprurëse dhe private të cilat zbatojnë programe për edukim financiar të temave të ndryshme nga sfera e fushëveprimit të tyre të punës, ku një pjesë e madhe e tyre tani për tani nuk janë të koordinuar në nivel nacional. Në vitin 2019, në nismë të sektorit privat bankar, në bashkëpunim me një pjesë të rregullatorëve financiar, filloi të organizohet Kuizi evropian i parave i destinuar për fëmijët të grupmoshës prej 13 deri 15 vjet. Numër i madh i subjekteve nga sektori privat (banka, fonde pensionale, fonde investuese, shoqëri për sigurime, ndërmjetës në sigurimet, institucione mikrofinanciare) sigurojnë aktivitete financiare, veçanërisht të destinuara për popullsinë e re. Mirëpo, nuk është e njohur se çfarë është dhe sa është ndikimi i secilës nga nismat ose programet mbi nivelin e arsimimit financiar tek popullsia.

Në pjesën e mbrojtjes së konsumatorëve, vërehet nevoja për mbindërtim të rregullativës ekzistuese dhe harmonizimi i saj me standardet evropiane në këtë sferë.

⁴ Në sistemin ekzistues arsimor, edukimi financiar është i kyçur pjesërisht përmes aspekteve të veçuara në kuadër të lëndëve Shkathtësitë e jetesës, Matematika, Shoqëria, Ndërmarrësia dhe inovacione në arsimin fillor.

Kujdes i veçantë nevojitet në lidhje me çështjet e përkufizimit të një mandati të qartë të institucioneve rregullatore për mbikëqyrje përkatëse të këtij segmenti të punës, si dhe mbulesë përkatëse me rregullativë përkatëse të llojeve të ndryshme të produkteve dhe shërbimeve financiare që ekzistojnë në tregun. Sfidë e veçantë për rregullatorët paraqet vendosja e supervizionit të praktikave afariste (angl. market conduct supervision) të subjektëve financiar me udhëzim të qartë drejt mbrojtjes së të drejtave të klientëve, si dhe ndarja e tij nga supervizioni prudent qëllimi i të cilit është mirëmbajtja e qëndrueshmërisë së sistemit. Edhe pse në nivel nacional ekziston kornizë e caktuar rregullatore dhe ndërmerren aktivitete nga ana e një numri të institucioneve rregullatore, megjithatë nuk ekziston sistem për mbrojtje të centralizuar dhe të koordinuar të konsumatorëve, përdorues të shërbimeve financiare, përfshirë edhe një sistem për zgjidhje juridike të ankesave të klientëve në sistemin financiar. Edhe pse përvojat në vende të veçuara janë të ndryshme, megjithatë përparësi i jepet ekzistimit të një trupi të pavarur i cili është i specializuar për shqyrtim dhe vendimmarrje objektive të ankesave nga klientët në institucionet financiare (që është e përmbajtur edhe në gjetjet e misionit FSAP të FMN-ës dhe Bankës Botërore, viti 2018). Aspektet lidhur me të drejtat e klientëve, së bashku me transparencën dhe zbatimin e praktikave të drejta nga ana e subjektëve privat financiar, në kushte bashkëkohore, janë faktor i rëndësishëm për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar, si një nga bartësit e zhvillimit ekonomik.

4. Aktivitete dhe masa për përmirësimin e edukimit financiar dhe inkluzionin financiar

4.1. Aktivitete dhe masa për përmirësimin e edukimit financiar

1. Përforcimi i vetëdijes për edukimin financiar në bazë të gjerë, me përfshirje të të gjitha institucioneve dhe subjekteve të interesuara financiare, asociacione, organizata joqeveritare, të cilat mund të ofrojnë programe arsimore për popullsinë, anëmbanë territorit të shtetit. Paralelisht, përforcim i koordinimit të subjektëve të përfshirë në procesin e edukimit, me qëllim të optimizimit të resurseve dhe ofrim i programeve të llojllojshme edukative në përputhje me nevojat e ndryshme të popullsisë.

Masa: inkuadrim i regjistrit të subjektëve të cilët janë aktivë në fushëveprimin e edukimit financiar, përfshirë edhe mundësinë për e-regjistrim.

Insitucione kompetente: Trupi koordinues për edukim dhe inkluzion financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e tij;

2. Vendosja e kompetencave bazë në sferën e financave, të cilat duhet të zhvillohen dhe të mbindërtohen përmes programeve për edukim financiar. Kompetencat duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të veçuar për të gjitha grupmoshat, filluar nga mosha parashkollore, më pas për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe për popullsinë e moshuar.

Masa: përkufizim i grupmoshave, vendosje e kompetencave bazë për sfera të ndryshme të financave.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar;

3. Promovim dhe zhvillim i praktikave të mira në fushëveprimin e edukimit financiar në lidhje me programet arsimore të subjektëve të veçuar të cilët kanë aktivitete arsimore. Programet për edukim financiar duhet të mendohen ashtu që duhet të plotësojnë nevojat për arsimim financiar të publikut të tyre të synuar. Edukimi financiar duhet të konsiderohet si një proces i përgjeshëm, i vazhdueshëm, në veçanti duke marrë parasysh ndërlikshmërinë gjithnjë e më të madhe të tregjeve, nevojat e ndryshme financiare në etapat e ndryshme të jetës së njerëzve dhe nevojën për informata të ndryshme për menaxhim optimal me financat personale. Me hartimin dhe pranimin e Kodit të praktikave të mira sigurohen programe cilësore edukative, qasje e përkushtuar dhe korrekte nga ana e të gjithë subjektëve të kyçur në procesin e edukimit, përfshirë edhe nga sektori privat dhe civil.

Masa: ngritja e vetëdijësimit, nxitja e të gjithë subjektëve potencial të cilët mund të kryejnë trajnime të këtilla, caktimin e procedurave për shqyrtim të programeve arsimore, hartim i një dokumenti (kodi) për praktika të mira në fushëveprimin e edukimit financiar dhe miratimi i tij nga ana e subjektëve të cilët zbatojnë aktivitete edukative, zbatim të qasjes për selektim të praktikave më të mira të edukimit përmes testimit në praktikë.

Institucione kompetente: Trupi koordinues për edukim dhe inkluzion financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e tij;

4. Hartimi i mëtejshëm dhe publikimi i materialeve edukative, të shkruara në një gjuhë lehtë të kuptueshme, me përfshirje të temave aktuale nga sfera e financave, të publikuara në mënyrë e cila siguron qasshmëri deri te një pjesë më e madhe e popullsisë. Nevojitet përqëndrim i veçantë i edukimit në lidhje me produktet dhe shërbimet bashkëkohore financiare.

Masa: rritje e vetëdijësimit tek të gjithë subjektët relevantë të cilët mund të kontribuojnë në këtë sferë, ndjekje të përvojave botërore në fushëveprimin e

hartimit dhe kanaleve për distribuim të materialeve edukative për popullsinë e gjerë.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, sektori privat financiar, organizatat joqeveritare;

5. Aktivitete të mëtejme për mësimin e edukimit financiar në procesin arsimor, përmes një lënde të veçantë ose kyçje të segmentëve të veçuar në lëndët ekzistuese (që edhe në kushtet ekzistuese është pjesërisht e pranishme) në arsimin fillor dhe të mesëm.

Masa: trajnime për kuadrin arsimor, zhvillim i materialeve edukative arsimore, bashkëpunim me ministrinë kompetente.

Institucione kompetente: Ministria e arsimit dhe shkencës, Trupi koordinues për edukim dhe inkluzion financiar, çdo institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

6. Rritje e arsimimit financiar tek popullsia e moshuar, përmes përkufizimit të grupeve të synuara (siç është popullsia femërore, të papunësuarit e të ngjajshme) dhe hartim i disa moduleve të kurseve me qëllim të edukimit të tyre përkatës dhe informim më i mirë nga sfera e financave.

Masa: përkufizi i grupeve të synimit dhe trajnime përkatëse nga sfera e financave, përgatitja e materialeve përkatëse edukative.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, sektori privat financiar, shoqatat, organizatat joqeveritare;

7. Rritja e vetëdijësimit të subjektëve privat nga sektori financiar për rritjen e aktiviteteve me qëllim të edukimit dhe informimit më të hollësishëm të klientëve për të gjitha aspektet lidhur me produktet financiare. nevojitet koordinim i përforcuar i institucioneve rregullatore dhe subjektëve nga sektori privat në fushëveprimin e edukimit financiar dhe të informuarit e klientëve, si dhe shqyrtim i aktiviteteve përkatëse për këtë qëllim, duke ndjekur praktikat e mira në këtë sferë.

Masa: përkufizimi i sferave në të cilat nevojitet angazhim më i madh i subjektëve privat me qëllim të përmirësimit të diturive financiare të klientëve të tyre, si dhe mënyra në të cilat do të zbatohet edukimi financiar i klientëve (ligjërata, pyetësorë, këshilla).

Institucione kompetente. Sektori privat financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

8. Rritja e vetëdijes tek popullsia për llojet e ndryshme të produkteve financiare dhe për rreziqet e veçara në fushëveprimin e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve financiare, me qëllim të përforsimit të aftësisë për zgjedhje të drejtë dhe sjellje përkatëse në fushëveprimin e menaxhimit me financat personale.

Masa: aktivitete përkatëse edukative për produktet e veçara financiare dhe për rreziqet në segmentet e veçara financiare.

Institucionet kompetente: secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat, organizatat joqeveritare.

4.2. Aktivitete dhe masa për rritje të inkluzionit financiar

1. Analiza e rregullativës për mbrojtje të konsumatorëve në sfera të veçara të sistemit financiar dhe zhvillim i rregullativës përkatëse gjithëpërfshirëse për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave. Njëkohërisht, nevojitet organizim përkatës dhe ekipim kadrovik në institucionet rregullatore të sistemit financiar në këtë segment.

Masa: krijimi i bazave juridike për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e financave, ndjekje e kërkesave të BE-së në këtë fushëveprim.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

2. Rregullativa përkatëse në fushëveprimin e shërbimeve pagesore dhe zbatim i praktikave botërore për mbrojtjen e konsumatorëve në këtë sferë.

Masa: krijimi i bazave juridike për mbrojtje të konsumatorëve në sferën e shërbimeve pagesore, ndjekje e kërkesave të BE-së në këtë fushëveprim.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar, secili institucion rregullator në fushëveprimin e vet;

3. Përforsimi i komunikimit me konsumatorët në sferën e financave, me qëllim të perceptimit më të mirë të nevojave të tyre dhe reagim ndaj ankesave të tyre.

Masa: inkuadrimi i mundësisë në faqen e internetit të secilit subjekt privat financiar (ose rregullator) për dërgimin e ankesave/lëvdëratave, përkufizimi i mënyrës së shqyrtimit të ankesave dhe përgatitje e përgjigjeve për klientët.

Institucione kompetente: secili inistitucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat;

4. Aktivitete rreth inkuadrimin dhe përforsimit gradual të supervizionit të mbrojtjes së konsumatorëve në segmente të veçuara të sektorit financiar. Njëkohësisht, nevojitet edhe organizim përkatës dhe ekipim kadrovik edhe i subjektëve privat financiar në këtë fushëveprim.

Masa: trajnime të kuadrit, ndjekje e tendencave botërore në këtë sferë.

Institucione kompetente: secili inistitucion rregullator në fushëveprimin e vet;

5. Rritje e transparencës në punë dhe në publikimin e të dhënave për shërbime financiare nga ana e sektorit privat financiar, përfshirë edhe standardizimin e të dhënave të publikuara për të njëjtin lloj të shërbimit.

Masa: shqyrtim i të dhënave të publikuara për secilin lloj të shërbimit dhe përgatitje e një formulari standard me të gjitha të dhënat e dobishme, i cili do kërkohej nga secili subjekt privat financiar në segmentin përkatës të tregut.

Institucione kompetente: secili inistitucion rregullator në fushëveprimin e vet, sektori privat financiar, shoqatat;

6. Shqyrtim i mundësive juridike (si ndërmjetësim) për zgjidhjen e kontesteve eventuale me konsumatorët, përfshirë edhe shqyrtimin e mundësisë për vendosje të një Ombudsmani për sektorin financiar.

Masa: shqyrtim i përvojave nga vendet tjera, krijimin e parakushteve përkatëse ligjore.

Institucione kompetente: aktivitet i koordinuar i institucioneve rregullatore të sistemit financiar;

7. Krijimi i bazës statistikore për numrin dhe llojin e ankesave, sipas subjektëve të veçuar juridik, në segmente të veçuara të sistemit financiar.

Masa: përcaktimi i procedurave për grumbullim ose informim për numrin dhe llojin e ankesave, sipas subjektëve të veçuar financiar.

Institucione kompetente: secili inistitucion rregullator në fushëveprimin e vet;

8. Krijimi i parakushteve për përmirësim dhe ndjekje më përkatëse të qasjes deri te financat nga ana e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe grupeve të tjera të synuara, me rëndësi të veçantë për zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e inkluzionit financiar.

Masa: inkuadrimi i anketave, pyetësorëve dhe përdorimi i burimeve të tjera të të dhënave (regjistri kreditor).

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar;

9. Aktivitete për përforcimin e aftësive të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për huamarrje, që duhet të lehtësojë qasjen e tyre deri te asetet financiare dhe rrjedhimisht të kontribuojë për zhvillim të qëndrueshëm të këtij segmenti dhe të ekonomisë në tërësi.

Masa: vendosja e një skeme kreditore garantuese, përmirësimi i praktikave menaxheriale dhe standardeve kontable për këto firma.

Institucione kompetente: ministritë kompetente;

10. Aktivitete për mbështetje dhe stimulim të inovacioneve financiare, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit financiar dhe shërbimeve, rrjedhimisht me sigurimin e inkluzivitetit më të madh.

Masa: koordinim midis institucioneve rregullatore të sistemit financiar dhe sektorit privat financiar, krijim i parakushteve përkatëse ligjore.

Institucione kompetente: aktivitet i koordinuar i institucioneve rregullatore të sistemit financiar;

11. Lehtësim i qasjes në financat e klientëve në mjediset e largëta rurale.

Masa: shqyrtim i mundësive për qasje më të mirë të klientëve deri te produktet dhe shërbimet financiare, analizë e përvojave nga vende tjera.

Institucione kompetente: sektori privat financiar, shoqatat;

12. Rritja e vetëdijësisimit për të drejtat e konsumatorëve në segmente të veçuara të sistemit financiar, përmes edukimit përkatës financiar;

Masa: lidhur me aktivitetet në pjesën për edukim financiar.

Institucione kompetente: institucionet rregullatore të sistemit financiar dhe sektori privat financiar.

4. Monitorim i zbatimit të strategjisë

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Strategjinë do mundësonte përfitime të numërta, të shprehura përmes: informimit më të mirë për produktet dhe shërbimet financiare; dituri më të mëdha për produktet dhe shërbimet bashkëkohore financiare; vetëdijësim i përforcuar për rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të produkteve të veçuara financiare dhe mbrojtja përkatëse nga ato; përforsim i aftësisë për sjellje të vendimeve të qëndrueshme financiare nga ana e popullsisë dhe rrjedhimisht mbajtja e stabilitetit financiar dhe rritja e mirëqenies.

Zbatimi i aktiviteteve të parapara në Strategjinë do të monitorohet përmes një numri të indikatorëve, ndër të cilët edhe këto në vijim:

1. Monitorim i numrit të personave të kyçur në trajnime, ligjërata, prezantime;
2. Pyetësor për diturinë para dhe pas trajnimeve, përfshirë edhe vlerësim të trajnimeve dhe programeve të veçuara;
3. Anketa dhe pyetësorë të kohë pas kohshme popullsisë;
4. Monitorim i indikatorëve për edukim dhe inkluzion financiar nga burime zyrtare (vendore dhe të huaja) statistikore;
5. Monitorim i zbatimit të masave të parapara në planet vjetore të veprimit të secilës nga institucionet e përfshira rregullatore.

Çdo institucion rregullator do ndërmerr masa për monitorim të aktiviteteve në fushëveprimin e tij të punës, ndërsa subjektët e përfshirë privat si dhe shoqatat qytetare do informonin për aktivitetet e zbatuara. Për çdo vit të zbatimit të Strategjisë, rregullatorët financiar përgatisin Plan të aktiviteteve (në dhjetor, për vitin e ardhshëm), ndërsa për çdo vit përgatitet Raport për aktivitetet e zbatuara (deri në shkurt të vitit rrjedhor, për vitin paraprak).⁵ Subjektët nga sektori privat dhe civil informojnë për aktivitetet e veta një herë në vit (deri në shkurt të vitit rrjedhor, për vitin paraprak) ose

⁵ Planet e aktiviteteve të rregullatorëve financiar për vitin 2021 janë të përpiluara në dhjetor të vitit 2020, duke marrë parasysh Propozim-Strategjinë dhe janë të dorëzuara drejtuar Trupit koordinues për edukatë financiare dhe inkluzion financiar.

rrjedhimisht, pas përfundimit të aktivitetit. Raportet për aktivitetet e veçuara të të gjithë subjektëve të përfshirë duhet të përmbajnë të dhëna për llojin e aktivitetit, përshkrim të përmbajtjes edukative, numrin e personave të përfshirë, sipas mundësisë edhe vlerësim të aktivitetit. Secili institucion i përfshirë në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parapara me Strategjinë duhet të planifikojë asete përkatëse financiare për realizimin e tyre.

Me qëllim të monitorimit të zbatimit të Strategjisë do të formohet grup punues për monitorim të zbatimit të Strategjisë. Ky grup punues duhet të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve rregullatore, shoqatave të sektorit privat dhe të sektorit joqeveritar. Qëllimi i tij do jetë që së paku dy herë në vit të takohet për të vendosur prioritetet dhe të vlerësojë detyrat e kryera gjatë vitit. Grupi punues do ketë detyrim që një herë në vit të përgatit dhe të dorëzojë Raport gjithëpërfshirës për zbatimin e Strategjisë deri te të gjitha institucionet e pëfshira.

Shtojca 1: Listë e lidhjeve të dobishme të internetit për përpunim të masave dhe aktiviteteve në segmente të veçuara

Titulli	Lidhja
1. <i>OECD's core competencies on financial literacy (2015-2019)</i>	Lidhje deri te faqja e internetit e INFE-OECD – Udhëzues për kompetencat kyçe (për investitorë (2019), për NVMM (2018), për popullsinë e moshuar (2016) dhe popullsinë e re (2015))
2. <i>OECD's guidelines for private and not-for-profit stakeholders in financial education (2014)</i>	Lidhje deri te OECD – Udhëzues për kyçjen e sektorit privat në edukimin financiar
3. <i>OECD's High-level principles on financial consumer protection (2011)</i>	Lidhje deri te G20/INFE-OECD – Parimet e mbrojtjes së konsumatorëve financiar
4. <i>G20/OECD's Ensuring financial education and consumer protection for all in the digital age (2017)</i>	Lidhje deri te G20/INFE-OECD – Raport për sigurimin e edukimit financiar dhe mbrojtje e konsumatorëve gjatë digjitalizimit
5. <i>G20/OECD Policy Guidance - Financial Consumer Protection Approaches in the Digital Age (2018)</i>	Lidhje deri te G20/OECD – Udhëzues për qasje për mbrojtjen e konsumatorëve financiar në epokën digjitale
6. <i>G20/OECD INFE Policy Guidance Digitalisation and Financial Literacy (2018)</i>	Lidhje deri te G20/OECD/GPFI – Udhëzues për digjitalizimin dhe arsimin financiar
7. <i>Personal Data Use in Financial Services and the</i>	Lidhje deri te OECD – Përdorimi i të dhënave personale për shërbime financiare dhe roli i edukimit financiar

<i>Role of Financial Education (2020) - A Consumer-Centric Analysis</i>	
8. <i>G20 High-Level Principles for Digital Financial Inclusion (2016)</i>	Lidhje deri te G20/GPFI – Parime për inkluzionin digjital financiar
9. <i>Digital Identity (2020)</i>	Lidhje deri te FATF – Udhëzues për identitet digjital
10. <i>National Strategies for Financial Education OECD/INFE policy handbook (2015)</i>	Lidhje deri te INFE-OECD – Udhëzues për strategji nacionale për edukim financiar
11. <i>Good practices for financial consumer protection, WB (2017)</i>	https://www.worldbank.org/en/topic/financialinclusion/brief/2017-good-practices-for-financial-consumer-protection
12. <i>Joint Committee (JC) Guidelines on complaints handling, EBA (2018)</i>	https://eba.europa.eu/sites/default/documents/files/documents/10180/2298559/b71d60e8-1ee2-4baa-844d-26760f11c80d/Extension%20of%20the%20Joint%20Committee%20Guidelines%20on%20complaints-handling%20%28JC%202018%2035%29.pdf

Shtojca 2: Listë e institucioneve dhe shoqatave të kyçura

- Institucione rregullatore të sistemit financiar (nënshkruese)

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Ministria e financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Agjencia e mbikëqyrjes së sigurimeve
Agjencia për mbikëqyrjen e financimit kapital të sigurimit pensional
Komisioni i letrave me vlerë

- Institucione të tjera shtetërore (bashkëpunëtorë të këshilluar)

Byroja e zhvillimit të arsimit

- Shoqata të subjektëve privatë financiar nga segmente të veçura të tregut dhe subjektë privat financiar (tek të cilët ishte e dorëzuar Strategjia për këshillim)

Asociacioni Bankar i Maqedonisë
Grupacioni i sigurimeve
Asociacioni i shtëpive të brokerimit për sigurime
Unioni i organizatave mikrofinanciare
Shoqëri private pensionale
Bursa e Maqedonisë
Depozitari qendror i letrave me vlerë
Shtëpi brokerimi
Shoqëri administruese të fondeve investuese
Asociacioni i shoqërive financiare

- Shoqata nga sektori civil (tek të cilët është dorëzuar Strategjia për këshillim)

Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë
Global shejpers Skopje hab Shkup
SIGMA STAT Shkup
Shoqata e klientëve bankar ANUITET
Shparkase fondacioni për bashkëpunim ndërkombëtar
Xhunionor açivment Makedonija
Instituti për hulumtime strategjike dhe edukim
Romalitiko - Shkup
Rrjeti ndëraktiv për arsim dhe resurse - Manastir

- Institucione të këshilluara ndërkombëtare:

INFE-OECD